Kronikë

Plagosje me armë zjarri në Durrës, 50-vjeçari qëllon pistoletë fqinjin pasi u shqetësua nga zhurma (VIDEO)

Një plagosje me armë zjarri ka ndodhur mbrëmjen e sotme (25 janar) në Durrës në lagjen nr.4. Burime për Report Tv bëjnë me dije se Gentian Kuqi, 50-vjeç ka plagosur me pistoletë me 2 plumba komshiun e tij Mikel Spirollari, 40-vjeç. Ky i fundit është dërguar me urgjencë për të në spitalin e Traumës në Tiranë

Redaksia
25 Janar, 22:39 | **Përditësimi: 25 Janar, 23:06**

Share

DURRËS- Një plagosje me armë zjarri ka ndodhur mbrëmjen e sotme (25 janar) në Durrës në lagjen nr.4. Burime për Report Tv bëjnë me dije se Gentian Kuqi, 50-vjeç ka plagosur me pistoletë me 2 plumba komshiun e tij Mikel Spirollari, 40-vjeç. Ky i fundit është dërguar me urgjencë për në spitalin e Traumës në Tiranë.

Shkak për plagosjen, thonë burimet, dyshohet se është bërë zhurma që bëhej në banesën e Spirollarit. Fillimisht ka pasur një konflikt verbal, i cili më pas ka agravuar në përdorimin e armës, e për pasojë ka mbetur i plagosur 40-vjeçari.

Autori Gentian Kuqi, pasi ka plagosur fqinjin është larguar, ndërsa policia është vënë në ndjekje të tij.

LEXO EDHE:
Operacioni 'Tempulli 2', lihen në burg 35 nga 43 të arrestuarit në Durrës, 1 në arrest shtëpie! Në Elbasan 18 në burg, 1 arrest shtëpie

'Në lagjen nr 4 në Durrës, si pasojë e një konflikti të çastit, shtetasi G.K, 50 vjeç, ka plagosur me armë zjarri pistoletë shtetasin M.S, 40 vjeç, (komshi), i cili është transportuar menjëherë në spital për ndihmë mjekësore. Shërbimet e Policisë me marrjen e njoftimit kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe kanë rrethuar zonën dhe vijon puna për kapjen e autorit, i cili pas plagosjes së shtetasit M.S, është larguar menjëherë nga vendi i ngjarjes. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorit vijon punën për zbardhjen dhe dokumentimin e rrethanave të ngjarjes. Pas sqarimit të rrethanave të ngjarjes do të ketë njoftim të dytë.'- njofton policia.

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Durres | plagosje | mikel spirollari | gentian kuqi

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Sipas jush kush duhet ta ketë bashkëkryetarin tek 'Zgjedhorja' nga opozita?

PD e Bashës | Bardhi-Berisha | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

Nënkomisari vetëvritet me armën e shërbimit në zyrë brenda në Komisariatin e Durrësit! U pezullua nga detyra pas dënimit për plagosje
25 Janar, 17:30

'Tempulli 2'/ Në kërkim për prodhim dhe shitje kanabisi, në pranga 31-vjeçari në Durrës
25 Janar, 09:51

Tiranë, grabitet dhe plagoset taksisti në 'Rrugën e Kavajës', 'Shqiponjat' arrestojnë 24 vjeçarin
25 Janar, 09:28

11 raste me fruth në Shqipëri, drejtoresha e ISHP Tomini për Report Tv: Të infektuarit janë 1-13 vjeç! Shpërndarja në tre qytete, si paraqitet situata
Ledina Jakimi
24 Janar, 16:21

Fruthi konfirmohet në Shqipëri, burime nga ISHP: 11 raste në Tiranë e Durrës
Ledina Jakimi
24 Janar, 11:56

U plagos dje në fshatin Krujë, 42-vjeçari arrestohet nga SPAK në spitalin e Traumës! Ishte në kërkim
23 Janar, 13:24

'Tempulli 2'/ 52 të arrestuar në Durrës, sekuestrohet kanabis, kokainë, armë e gati 16 mijë euro
23 Janar, 10:21

Begaj viziton anijen ushtarake të Marinës britanike pranë Durrësit
22 Janar, 17:24

Krujë/ Plagoset me armë zjarri 42 vjeçari në fshatin Bru Zallë, transportohet drejt Traumës për shkak të hemorragjisë! Policia në kërkim të autorit (EMRAT)
22 Janar, 14:13

Operacioni antidrogë, 67 të arrestuar në Durrës! Kapen me doza kanabisi
22 Janar, 10:32

'Tempulli 2'/ Operacion antidrogë në gjithë vendin, goditen 7 grupe kriminale! 273 të arrestuar në Tiranë e 5 qytete! Sekuestrohen mbi 567 kg drogë, armë e valutë
Sokol Dema
22 Janar, 07:14

Në Porto Romano është thyer embargo me Rusinë
Anila Hoxha
21 Janar, 10:48

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje